

## Njoftim aplikimi për transferim licence

Në zbatim të nenit 40, pika 1 e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa ”a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; si dhe nenit 10, pika 8 dhe 9 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, njoftojmë si vijon:

- shoqëria “EZ-ENERGY” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për transferimin e licencës së saj për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, te shoqëria “EZ TRADING” shpk;
- shoqëria “EZ-5 ENERGY” shpk ka aplikuar në Entin Rregullator të Energjisë për transferimin licencës së saj të të energjisë elektrike te shoqëria “EZ5 TRADING” shpk.

Në mbledhjen e datës 28.05.2026, Bordi i ERE-s vendosi të fillojë procedurën për transferimn e secilës prej licencave të mësipërme, nga “EZ-5 ENERGY ” shpk te shoqëria “EZ5 TRADING shpk.

Ftohen palët e interesuara të shprehin opinionet dhe komentet e tyre me shkrim në lidhje me secilën prej kërkesave për tansferim, brenda 10 (dhjetë) ditëve (nga data 30.05.2026 deri me 08.06.2026) pranë zyrave të ERE-s, në adresën: në adresën: Rruga “Irfan Tomini”, Njësia Administrative Nr. 7, Tiranë, ose në postën elektronike, në adresën [erealb@ere.gov.al](mailto:erealb@ere.gov.al).